

**KUSHTE TË PËRGJITSHME PËR PJESËMARRJE NË LOJËN E FATIT LOTO  
7/37 DHE LOJËS PLOTËSUESE XHOKER PËRMES VEB FAQES TË  
„Lotarisë shtetërore të Maqedonisë,,**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITSHME**

**Neni 1**

Kushtet e përgjithshme për pjesëmarrje në lojën e fatit Loto 7/37 dhe lojës plotësuese Xhoker (në tekstin e mëtejshëm: loja loto dhe xhoker ose loja) përmes veb faqes të „Lotarisë shtetërore të Maqedonisë,,(në tekstin e mëtejshëm:organizatori) paraqesin pasqyrë të kushteve për lojën Loto dhe Xhoker, kushte për të cilat pëlqim ka dhënë Ministria e financave, me të cilat rregullohet mënyra për pjesëmarrje në lojë përmes veb faqes të organizatorit (lojë on-line).

Kushtet e përgjithshme për pjesëmarrje në lojën loto dhe xhoker, përmes veb faqes të organizatorit kanë qëllim të shpjegojnë dhe ta afrojnë lojën deri të personi fizik i regjistruar si pjesëmarrës në lojë (në tekstin e mëtejshëm: pjesëmarrës).

**Neni 2**

Raporti marëveshës i organizatorit dhe pjesëmarrësit në lojë përmes veb faqes të organizatorit hynë në fuqi me regjistrimin e suksesshëm në Profilin e shfrytëzuesit, në mënyrë të paraparë në pajtim me rregullat e lojës loto dhe xhoker.

Право за учество во играта преку веб страната на приредувачот имаат полнолетни физички лица.

**Neni 3**

Organizatori obligohet, në kohën e organizimit të lojës përmes veb faqes të organizatorit të mundëson zbatim të rregullave për lojë të përgjegjshme, mbrojtje të personave minorë, parandalim rreth varësisë të pjesëmarrësve në lojë, mbrojtje e të dhënave personale të pjesëmarrësve në lojë.

**II. PËRSHKRIM DHE DEFINICIONE TË TERMEVE**

**Neni 4**

Fjalët dhe termet të përdorura në këto Kushte të përgjithshme kanë kuptimin.

- ORGANIZATORË – Lotaria shtetërore e Maqedonisë SHA, rruga “Goce Dellçev” nr. 8 f.p. 506, 1000 Shkup;
- INTERNET FAQJA E ORGANIZATORIT – [www.loto.mk](http://www.loto.mk) ;
- LOJË PËRMES VEB FAQES TË ORGANIZATORIT ( lojë on-line) – pjesëmarrje në lojën e fatit përmes veb faqes të organizatorit ku pjesëmarrësi mund të paguan lojë në interakcion me sistemin qendror, pa patur nevojë për medijatorë të organizatorit;
- SHRYTËZUES – person fizik i moshës mbi 18 vjeç, i cili është qasur përmes veb faqes të organizatorit, dhe nuk ka Profil të shfrytëzuesit të regjistruar;

- PJESEMARRËS – person fizik me moshë mbi 18 vjeç, i cili përmes veb faqes të organizatorit ka të regjistruar Profil të shfrytëzuesit me qëllim të pjesëmarrjes në lojë loto ose xhoker përmes veb faqes të organizatorit;
- PROFILI I SHFRYTËZUESIT – profil personal i shfrytëzuesit i pjesëmarrësit në lojë përmes veb faqes të organizatorit, i cili krijohet gjatë regjistrimit në veb faqen e organizatorit në të cilin qasja është e mbrojtur me emër dhe fjalëkalim;
- LLOGARI E PROFILIT TË SHFRYTËZUESIT – llogaria unike e shfrytëzuesit e cila krijohet në mënyrë automatike gjatë regjistrimit të Profilin të shfrytëzuesit dhe në të cilën mbahen dhe evidentohen të gjitha depozitet e paguara, të gjitha fitimet e realizuara, të gjitha pagesat e fitimeve të bëra përmes Profilin të shfrytëzuesit si dhe të gjitha transaksionet të kryera nga llogaria e Profilin të shfrytëzuesit në llogarinë bankare të pjesëmarrësit.
- NUMRI I LLOGARISË I PROFILIT TË SHFRYTËZUESIT – numër unik i cili e përcakton llogarinë e Profilin të shfrytëzuesit të pjesëmarrësit;
- EMËR I SHFRYTËZUESIT DHE FJALËKALIM – mjet për identifikim dhe mbrojtje për qasje në Profilin e shfrytëzuesit. Përbëhen nga radhë prej dy karaktere alfanumerike (nga një për emrin e shfrytëzuesit dhe fjalëkalimin);
- LLOGARIA E TRANSAKSIONIT E PJESEMARRËSIT – llogaria e transaksionit në bankë me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pronari i së cilit është pjesëmarrësi në lojë dhe nga e cila pjesëmarrësi mund të kryen pagesën e depoziteve në llogarinë e Profilin të shfrytëzuesit dhe në të cilën mund të kryen pagesë të mjeteve nga llogaria e Profilin të shfrytëzuesit;
- DEPOZIT/ PAGESË – mjete financiare të cilat janë të deponuara në llogarinë e Profilin të shfrytëzuesit dhe përdoren për nevojat e pjesëmarrësit të merrë pjesë në lojë përmes veb faqes të organizatorit;
- FITIMI – shumë e të hollave ose tjetër lloj fitimi të cilën pjesëmarrësi ka realizuar në lojën e fatit përmes veb faqes të organizatorit;
- BONUS – mjete për promovim të lojës të cilat organizatori i ndan në llogarinë e urdhëresës të Shfrytëzuesit në mënyrë të definuar me Vendim të organizatorit për të cilën është i detyruar paraprakisht para fillimit të zbatimit të Vendimit, ti njofton pjesëmarrësit në lojë. Bonuset mund të shfrytëzohen vetëm për pagesë të lojës dhe nuk mund të pagohen nga llogaria e urdhëresës të shfrytëzuesit.
- VËRTETIM ELEKTRONIK PËR PAGESË – regjistrim elektronik i vërtetimit në sistemin qendror kompjuterik të organizatorit e cila është është shënuar me numër të identifikimit të transaksionit dhe është e lidhur me llogarinë e profilin të shfrytëzuesit të pjesëmarrësit.

### **III. REGJISTRIMI I PROFILIT TË SHFRYTËZUESIT**

#### **Neni 5**

Pjesëmarrësi e regjistron Profilin e shfrytëzuesit me qasje në “REGJISTROHU” në veb faqen e organizatorit me deponimin e të dhënave personale dhe pranon kushtet e lojës dhe kushtet e përgjithshme për pjesëmarrje në loto dhe xhoker në

veb faqen e organizatorit me zgjidhjen e opcionit “I pranoj të gjitha dispozitat dhe kushtet për lojë”.

Me pranim të kushteve të përgjithshme për pjesëmarrje në loto dhe xhoker përmes veb faqes të organizatorit , organizatori është i detyruar përmes email-it të pjesëmarrësit ti dërgon link për vërtetim dhe aktivim të Profilit të shfrytëzuesit. Pa vërtetim të linkut të dërguar në email, profili i shfrytëzuesit nuk do të jetë aktiv.

Pjesëmarrësi mund të regjistrohet vetëm një Profil të shfrytëzuesit në veb faqen e organizatorit.

Me një NUAQ të njejtë mund të regjistrohet vetëm një Profil i shfrytëzuesit në veb faqen e organizatorit. Nëse më është i regjistruar Profil i shfrytëzuesit me një NUAQ tentimi për regjistrim të profilit të dytë me atë numër të njejtë nuk është i lejuar dhe paraqitet mesazh se egziston profili i shfrytëzuesit me atë NUAQ.

Regjistrimi i pjesëmarrësit është proces i marrjes përsipër dhe deponimit e të dhënave për pjesëmarrësin në lojën loto dhe xhoker përmes veb faqes të organizatorit. Me vetë regjistrimin të Profilit të shfrytëzuesit pjesëmarrësi jep pëlqimin për mbledhjen e të dhënave të pjesëmarrësit dhe përpunimin e tyre me qëllim të mundësisë të pjesëmarrjes në lojën loto dhe xhoker përmes veb faqes të organizatorit dhe njëkohësisht autorizon organizatorin të kryen kontrollë të vlefshmërisë e të dhënave personale të deponuara në procesin e regjistrimit të Profilit të shfrytëzuesit.

Gjatë procesit të regjistrimit, pjesëmarrësi duhet detyrimisht saktë të mbushë formularin e dhënë për regjistrim i cili përmban këto të dhëna:

1. TË DHËNA PERSONALE: tituli, emri dhe mbiemri, gjinia, shteti, adresa, vendbanimi (komuna), numri postar, data e lindjes, vendi i lindjes, email, vërtetim i emailit, numri i telefonit;
2. IDENTIFIKIM PERSONAL: NUAQ, numri i llogarisë bankare;
3. TË DHËNA PËR REGJISTRIM: emri i shfrytëzuesit, fjalëkalimi, vërtetim për fjalëkalim, pyetje e sigurisë, përgjigje e sigurisë;
4. REGULLIM: shuma e transaksionit në denarë, gjuha, mënyra e zgjedhur e komunikimit, informatë për veprimtari dhe aktivitete afariste, si ke kuptuar për ne;

Pjesëmarrësi detyrimisht duhet ti plotëson fushat nga formulari i dhënë gjatë regjistrimit, të shënuara me “Detyrimisht”.

Pasi të shënohen të dhënat personale, Organizatori me kontrollë të NUAQ dhe datën e lindjes konfirmon a është personi me moshë mbi 18 vjeç.

Shfrytëzuesi i cili nuk do të shënon opcionin “I pranoj të gjitha dispozitat dhe kushtet për lojë” në veb faqen e organizatorit, nuk do të regjistrohet, gjegjësisht personi në fjalë nuk do ta fiton të drejtën të bëhet pjesëmarrës në lojën loto dhe xhoker përmes veb faqes të organizatorit.

Gjatë regjistrimit të suksesshëm të Profilit të shfrytëzuesit, pjesëmarrësi është i obliguar regullisht ti azhuron të dhënat personale.

Pjesëmarrësi gjatë regjistrimit të Profilit të shfrytëzuesit në zgjedhjen e Emrit të shfrytëzuesit nuk mund të përdor terme të cilat mendohet se janë fyese dhe diskriminuese në çfarëdo baze, dhe në rast ato të përdoren, organizatori mund të refuzon regjistrimin e profilit, dhe të njejtin do ta shuan pa dhënë shpjegim.

Pjesëmarrësi obligohet të mban në fshehtësi fjalëkalimin e vet i cili është e njohur vetëm për të (fjalëkalimi nuk është i njohur dhe në dispozicion për organizatorin)

dhe për atë shkak i njejtë është përgjegjës për rrezikun nga keqpërdorimi eventual i fjalëkalimit.

Pjesëmarrësi obligohet të ruan në fshehtësi përgjigjen e pyetjes të sigurisë e cila shfrytëzohet si kontrollë plotësuese e sigurisë në veprime të veçanta gjatë përcaktimit të identitetit.

Në rast kur shfrytësi harron fjalëkalimin dhe kërkon një të ri me klikim në linkun “fjalëkalim i haruar”, organizatori është i detyruar përmes emailit pjesëmarrësit ti dërgon instruksione për ndryshim të fjalëkalimit.

Të gjitha transaksionet e kryera përmes Profilin të shfrytëzuesit me emër valid të shfrytëzuesit dhe fjalëkalim do të konsiderohen si të vlefshme, me kusht që pjesëmarrësi në Llogarinë e profilin të shfrytëzuesit të disponojë me mjete të mjaftueshme që të mund të kryen pagesë për lojë të cilën dëshiron ta luan përmes veb faqes të organizatorit.

Në raste të ndryshimit e të dhënave të shfrytëzuesit pjesëmarrësi është i obliguar menjëherë të informon organizatorin ashtu që përmes veb faqes të organizatorit në Profilin e vet të shfrytëzuesit vetë do të ndryshon të dhënat e shfrytëzuesit (përveç: datës dhe vendit të lindjes, NUAQ, email-it, valutës, emrit të shfrytëzuesit). Në të kundërtën përgjigjet për të gjitha lëshimet që janë bërë për shkak të mosinformimit të organizatorit për ndryshimet që kanë ndodhur.

Për vërtetësinë e të dhënave personale të deponuara në procedurën e regjistrimit të Profilin të shfrytëzuesit, përgjigjet pjesëmarrësi i cili ka hapur Profilin e shfrytëzuesit.

Nëse gjatë procedurës të kontrollimit të të dhënave të deponuara, organizatori përcakton të dhëna jo të sakta përkatësisht nëse kontrolli vërteton se pjesëmarrësi nuk i përmbush kushtet për pjesëmarrje në lojërat e fatit përmes veb faqes të organizatorit, të parapara me rregullat e lojës loto dhe xhoker, në atë rast pjesëmarrësit nuk do të lejohet regjistrimi i Profilin të shfrytëzuesit derisa pjesëmarrësi nuk deponon të dhëna të vlefshme dhe te rregullta në Profilin e tij të shfrytëzuesit.

## **IV LLOGARIA E PROFILIT TË SHFRYTËZUESIT**

### **Neni 6**

Gjatë procedurës të regjistrimit të profilin të shfrytëzuesit automatikisht krijohet Llogari e profilin të shfrytëzuesit në të cilën evidentohen dhe mbahen të gjitha depozitet e paguara, të gjitha pagesat, fitimet e realizuara dhe të gjitha pagesat e fitimeve të kryera nga Profili i shfrytëzuesit në fjalë.

Pjesëmarrësi mund të kryen pagesë të depozitit në Llogarinë e shfrytëzuesit përmes transferit nga kartela e tij pagesore në bankën e tij me seli në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me thirrje të numrit i cili në mënyrë unike e përcakton Llogarinë e profilin të shfrytëzuesit të pjesëmarrësit.

Pjesëmarrësi është i detyruar të kontrollon gjendjen e Llogarisë të profilin të shfrytëzuesit gjatë çdo paraqitjeje. Në rast të çfarëdo lloj jopërthpushmërie në Llogarinë e profilin të shfrytëzuesit me evidencën personale të pjesëmarrësit rreth transaksioneve, pjesëmarrësi është i detyruar pa shtyerje të mëtejshme të informon

organizatorin me qëllim të koordinimit dhe ndërmarrjes të masave eventuale të duhura mbrojtëse.

Pjesëmarrësi mundet në çdo kohë të paraqet një kërkesë për mbyllje të Llogarisë të profilit të shfrytëzuesit, përmes emailit në helpdesk@loto.mk, në selinë e organizatorit ose me letër të dërguar përmes postës. Kërkesa për mbyllje të profilit të shfrytëzuesit është e shpallur në veb faqen e organizatorit.

Llogari të profilit të shfrytëzuesit njëherë të mbyllur, pjesëmarrësi mund përsëri ta hap përmes emailit në helpdesk@loto.mk, në selinë e organizatorit ose me letër të dërguar përmes postës.

Organizatori mban të drejtën të mbyll llogarinë të profilit të shfrytëzuesit të pjesëmarrësit nëse i njëjti nuk përmbush kushtet në pajtim me rregullat e lojës.

Gjatë pagesës të lojës përmes veb faqes të organizatorit, pjesëmarrësi patjetër të ketë mjete të mjaftueshme të evidentuara në Llogarinë e profilit të shfrytëzuesit.

Për pagesë të lojës përmes veb faqes të organizatorit, pjesëmarrësi patjetër duhet të kryen vërtetim të dyfishtë të transaksionit të dëshiruar për pagesë të lojës.

Një transaksion i përfunduar për pagesë të lojës nuk mund të anulohet. Organizatori nuk është përgjegjës për gabime gjatë shkrimit, gabimit njerëzorë, gabimit softuerik.

Nëse pjesëmarrësi në lojën përmes veb faqes të organizatorit korespondon me mjete për lojë nga burime të ndryshme (pagesë e cila është kryer në Llogarinë e profilit të shfrytëzuesit, fitime dhe bonuse), sistemi për organizim së pari do të shfrytëzon bonuset, më pas mjetet e paguara dhe mjetet nga fitimet. Bonus lojë paraqet mjete për promovim të lojës të cilën e ndan organizatori në Llogarinë e profilit të shfrytëzuesit të pjesëmarrësit në mënyrë të definuar me Vendim të organizatorit. Bonuset mund të përdoren vetëm për pagesë të lojës dhe nuk mund të pagohen nga Llogaria e profilit të shfrytëzuesit.

Pjesëmarrësi mund të kërkon tërheqje të mjeteve financiare të cilat i ka paguar në Llogarinë e profilit të vet të shfrytëzuesit si depozit në mënyrë e cila është e përshkruar në këto Kushte të përgjithshme për pjesëmarrje në lojën loto dhe xhoker, duke i përfshirë dhe fitimet e realizuara, dhe Organizatori është i obliguar mjetet e kërkuara ti paguan në afat prej 72 orësh nga iniciativa për tërheqje të mjeteve.

## **V VËRTETIM ELEKTRONIK PËR PAGESË**

### **Neni 7**

Vërtetim elektronik për pagesë paraqet informatë elektronike për vërtetim të pagesës në sistemin qendror kompjuterik të organizatorit, i cili është shënuar me numër identifikues të transaksionit dhe është lidhur me Llogarinë e profilit të shfrytëzuesit të pjesëmarrësit.

Në rast të mospërputhshmërisë në shenjat mes vërtetimeve elektronike, të cilat gjenden te pjesëmarrësi dhe të dhënat e regjistruara nga sistemi qendror të cilat si të tilla janë të deponuara në thesarin e organizatorit, fitimet vërtetohen në bazë të shenjës të të dhënave të regjistruara në thesarin e organizatorit.

Vërtetimi elektronik fitues i përket pjesëmarrësit i cili ka të regjistruar Profil të shfrytëzuesit të personalizuar nga e cila është kryer pagesa elektronike, dhe për atë

arsye konsiderohet si bartës në aspekt të këtyre kushteve të përgjithshme dhe regullave të lojës të fatit.

## **VI PAGESA E FITIMEVE**

### **Neni 8**

Çdi fitim që pjesëmarrësi në lojë do ta realizon përmes veb faqes të organizatorit, sistemi kompjuterik i organizatorit do ta evidenton përmes Llogarisë të profilit të shfrytëzuesit.

Fitimet e realizuara transferohen në Llogarinë e profilit të shfrytëzuesit të pjesëmarrësit pasi që organizatori do të konfirmon pagesën të fitimeve në sistemin qendror kompjuterik të vetë.

Nga Llogaria e profilit të shfrytëzuesit mund të pagohen vetëm mjete të cilat janë të disponueshme për pagesë.

Pagesë nga Llogaria e profilit të shfrytëzuesit të pjesëmarrësit e evidentuar te organizatori deri në lartësi të përcaktuar me Vendim të organizatorit.

Organizatori e mban të drejtën të korigjon transaksionin financiar të fitimit të paguar në Llogarinë e profilit të shfrytëzuesit, nëse pagesa është kryer në bazë të gabimit teknik ose rezultat i evidentuar në mënyrë të gabuar, dhe për atë mund të bën rikthim të mjeteve të evidentuara gabimisht.

Të dhënat për llogarinë të transaksionit pjesëmarrësi i jep vetëm për të shërbyer për pagesë të mjeteve nga fitimet ose kthim të mjeteve paraprakisht të paguara. Organizatori nuk ka asnjë mundësi të disponon me mjetet e asaj llogarie.

Para se të paraqet kërkesë për pagesë të llogarisë, pjesëmarrësi është i detyruar në fushën për regjistrim të Profilit të vet të shfrytëzuesit të shkruan numrin e vet të transaksionit në të cilin dëshiron ti realizohet pagesa. Pjesëmarrësi është i detyruar, me kërkesë të dorëzon dëshmi për pronësi të llogarisë transaksionare. Nëse pjesëmarrësi nuk dorëzon dëshmi për pronësi të llogarisë, organizatori ka të drejtë të refuzon kërkesën për transfer të mjeteve. Organizatori nuk është përgjegjës nëse pjesëmarrësi gabimisht ka shkruar numrin e llogarisë të transaksionit ose nëse është përgjegjëse banka përmes të cilës kryhet transferi i mjeteve.

Nga momenti i dorëzimit të kërkesës për pagesë të mjeteve në llogarinë e tij të transaksionit, mjetet e kërkuara rezervohen në Llogarinë e profilit të shfrytëzuesit të pjesëmarrësit dhe me këto mjete pjesëmarrësi mund të disponon deri në kryerjen e transferit në llogarinë aktuale të pjesëmarrësit, gjegjësisht deri në momentin e pagesës të mjeteve të përgjithshme.

Transferi i mjeteve nga Llogaria e urdhëresës të shfrytëzuesit në llogarinë aktuale të pjesëmarrësit kryhet kur banka do të konfirmon se është kryer transferi i mjeteve. Moment i pagesës në llogarinë e transaksionit njihet ai moment i rezervimit të shumave nga mjetet në Llogarinë e profilit të shfrytëzuesit të pjesëmarrësit. Organizatori nuk bart përgjegjësi për transfer të mjeteve në Llogarinë e profilit të shfrytëzuesit në llogarinë të transaksionit të pjesëmarrësit, as për kohëzgjatjen e këtij transferi të mjeteve.

## **VII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 9**

Organizatori është i detyruar të dhënat e fituara të pjesëmarrësve në lojërat e fatit përmes veb faqes të organizatorit ti ruan si sekret dhe të vepron me të njejtat në pajtim me rregullat ligjore dhe rregullat e lojës të organizatorit. Organizatori i ndërmer të gjitha masat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe keqpërdorim të tyre, shkatërrim, humbje, qasje e paautorizuar ose ndryshim i të dhënave.

### **Neni 10**

Organizatori është i detyruar ti ruan informatat elektronike së paku një vit duke filluar nga dita e tërheqjes të një gjiroje të caktuar.

Vetëm në rast kur është filluar një proces gjyqësor për shkak të ushtrimit të të drejtave nga pjesëmarrja në lojën loto dhe xhoker, Organizatori është i detyruar ti ruan informatat elektronike të vërtetimeve deri në përfundimin ligjor të procedurave gjyqësore.

### **Neni 11**

Për zgjedhje të procedurave gjyqësore të cilat nxjerren nga pjesëmarrja në lojën loto dhe xhoker, kompetente është Gjykata themelore civile në Shkup.

### **Neni 12**

Këto kushte të përgjithsme, do të shpallen në veb faqen e organizatorit.